



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 78.
Prishtinë, më 8.10.2013 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Vesna Mikic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-së, Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësues nga IND- ja Xhemajl Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, ECMI Lura Pollozhani dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu, Fjolla Gashi - praktikante e UNDP-së .

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Živković –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbaleve në mbledhjet e mbajtura më 19 dhe 26.07.2013;
3. Shqyrtimi i Draft- Raportit për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave, me raport amandamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, me raport amandamente të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-196 për Fshatin Zymi i Hasit, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.**
7. **Të ndryshme**

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 19. dhe 26.07.2013.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 19.07.2013 dhe 26.07.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Draft- Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës

Kryesuesja – lidhur me draft raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligj do ta elaboroi zot. Elmi Reçica-. kryesues i grupit punues.

Elmi Reçica- Në bazë të Planit të Veprimit , Komisioni ka formuar Grupin Punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës. Grupi Punues ka bërë një varg aktivitete, ka pas takime të shumta me institucionet relevante, ka vizituar disa komuna.

Në fjalën e tij tha se për arsye të harmonizimit të disa pakjartësive në draft- raport, kërkoi që komisioni të ketë mirëkuptim dhe kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhje e radhës.

Kryesuesja – hodhi në votim kërkesën e zot. Elmi Reçica, dhe Komisioni nxori këtë;

Përfundim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim miratoi propozimin e kryesuesit të grupit punues Zot. Elmi Reçica, që të shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës,

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave me amandamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.**

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre me amendamentet e Komisionit funksional dhe njëherit kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente

Jasmina Zivkovic- tha se ka vërejtje në raportin e komisionit funksional lidhur me Nenin 3 gjegjësisht formulimin e **amendamentit 1**, ku bëhet fjalë për udhëheqjen e UÇK-së me qëllim të çlirimit të Kosovës dhe pavarësisë së popullit të Kosovës, e drejtuar ekskluzivisht kundër forcave ushtarake, policore dhe administratës okupuese serbe në Kosovë, dhe shtoi se kjo retorikë nuk duhet të ekzistoj në ligjet e Kosovës.

Ishte e mendimit se ky amendament duhet të fshihet

Elmi Reçica- të gjithë e dimë se ky projektligj është miratuar në Kuvend dhe se i njëjti është proceduar në formën më profesionale nga komisioni funksional. Ishte i mendimit se amendamenti 1, përshkruan vetëm çështjen historike të asaj kohe dhe se nuk ndikon negativisht në interesat e komunitetit pakicë që jetojnë në Kosovë.

Konsideron se ligji duhet të miratohet si i tillë dhe si propozim i dytë ishte që kjo pikë të shtyhet për takimin të përbashkët ku do të thërrasim kryetarin e komisionit funksional për të dhanë sqarime lidhur me këtë çështje.

Lumnjije Morina- mendon se formulimi i amendamentit 1, të këtij projektligji, nuk paraqet retorikë por përshkruhet historia e së kaluarës dhe kjo nuk është e dëmshme për komunitetin pakicë.

Mursel Haljili- pajtohet me propozimin e z. Elmi që Komisioni të bëjë ftesë kryetarit të komisionit funksional ku do të paraqesim pyetjet tona konkrete.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim do të ftojë kryetarin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për të ofruar sqarime lidhur me formulimin e amendamentit 1, në raportin e Projektligjit nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-196 për Fshatin Zymi i Hasit, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-196 për Fshatin Zymi i Hasit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-196 për Fshatin Zymi i Hasit dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Të ndryshme

Kryesuesja- theksoi se lidhur me monitorimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në vend të kryesuesit të Grupit Punues z. Goran Marinkovië i cili më nuk është anëtar i këtij komisioni dhe propozoi që ky grup të udhëhiqet nga znj. Jelena Bontic.

Komisioni për Komunitete dhe Kthim njëzëri miratoi propozimin që kryesuese e Grupit Punues të emërohet Jelena Bontic lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković